



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ANKIV ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot Broj. prot. Prot. no	Nr. i faq. Br. str. No. pages	Data: Datum: Date
157	157	02.03.2026
PRISTINË - PRISTINA - PRISTINA		

## RREGULLORE

# PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË ME PËRGATITJE TË MESËM DHE TË LARTË SHKOLLORE

Prishtinë 2026

**KUVENDI I ODËS SË INFERMIEREVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK)**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, si dhe Nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OIK, me datë 27.02.2026, miraton këtë:

**Rregullore për Praktikën Profesionale të Profesionistëve Shëndetësor me Përgatitje të Mesme dhe të Lartë Shkollore**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Me këtë rregullore rregullohen procedurat, kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për kandidatët me përgatitje të mesme shkollore me qëllim që të sigurojë: zhvillimin e aftësive praktike, teknike dhe etike të profesionistëve shëndetësorë, standardizimin e praktikës profesionale në institucionet shëndetësore publike dhe private dhe përgatitjen profesionale të kandidatëve për ushtrimin e pavarur të profesionit.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për profesionistët shëndetësorë, shtetas të Republikës së Kosovës, me shkollim të mesëm dhe të lartë (niveli IV dhe V).

**Neni 3  
Përkufizimet**

Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si më poshtë:

**OIK** – Oda e Infermierëve të Kosovës;  
**MSH** – Ministria e Shëndetësisë;  
**MASHTI** – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;  
**KPSh** – Kujdesi Parësor Shëndetësor;  
**KDSh** – Kujdesi Dytësor Shëndetësor;  
**KDTSh** – Kujdesi Dytësor dhe Tretësor Shëndetësor;  
**QKMF** – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare;  
**QMF** – Qendra e Mjekësisë Familjare;  
**AMF** – Ambulanca e Mjekësisë Familjare;  
**IKSHPK** – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

**Neni 4  
Përkufizime shtesë**

- 1. Praktikë profesionale** – është ushtrimi i profesionit nga ana e praktikantit për një periudhë të caktuar nën udhëheqjen dhe përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar dhe me përvojë, me qëllim për të fituar titullin profesional dhe aftësuar për ta ushtruar atë si i pavarur.
- 2. Praktikant/Kandidat** – profesionist shëndetësor i cili gëzon një dokument zyrtar të formimit profesional ose të kualifikimit profesional dhe kandidon për të ushtruar praktikën profesionale me qëllim fitimin e titullit të një profesioni të rregulluar.
- 3. Profesionist i kualifikuar me përvojë** – është profesionisti i cili disponon një dokument zyrtar aftësie apo kualifikimi profesional dhe ka ushtruar në mënyrë të ligjshme dhe e i pavarur profesionin mbi 3 (tre) vjet.

**4. Dokument zyrtar i formimit/kualifikimit profesional** – është diploma, certifikata ose dëftesa, lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, që certifikon përfundimin e suksesshëm të një formimi apo kualifikimi profesional, të zhvilluar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

**5. Institucion Shëndetësor** - konsiderohet spitali, poliklinika, qendra shëndetësore, klinika dentare, farmacia, ku praktikanti ushtron praktikën profesionale apo pjesë të saj, në përputhje me programin dhe profilin e tij.

#### **Neni 5 Praktika profesionale**

1. Praktika profesionale është e obligueshme për profesionistët shëndetësorë që kanë diplomuar në shkollë të mesme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Praktika profesionale është e obligueshme për profesionistët shëndetësorë, shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët kanë diplomuar jashtë vendit, pas nostrifikimit të diplomës në MASHTI.
3. Përmbajtja e praktikës profesionale përcaktohet në bazë të Rregullores për praktikën profesionale të profesionistëve shëndetësorë me shkollim të mesëm, të aprovuar nga Kuvendi i OIK.

#### **Neni 6 Kohëzgjatja e praktikës profesionale**

1. Praktika profesionale për të gjithë profesionistët shëndetësorë dhe bashkëpunëtorët profesionalë zgjat gjashtë (6) muaj pas diplomimit.
2. Plan programi i praktikës profesionale, sipas fushave të përcaktuara, në mbështetje të nenit 69 paragrafi 1.11, 1.12 të Ligjit me Nr.04/L-125 për Shëndetësi është i detajuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje, për profilet me përgatitje të mesme dhe të lartë shkollore (niveli IV dhe V), si më poshtë:
  - Të gjitha profilet Bashkëpunëtor, Infermier/Mami dhe Pediatri;
  - Profilet Teknike Stomatologjike;
  - Teknik i Fizioterapisë;
  - Teknik i Farmacisë;
  - Teknik i Radiologjisë me përgatitje të mesme;
  - Teknik Laborant;
  - Teknik për Fitnes dhe Nutricion;
  - Teknik i Optikës.
3. Kohëzgjatja e praktikës profesionale e filluar në institucionin shëndetësor përkatës duhet të përfundohet në përputhje me afatet dhe përmbajtjen e përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 7 Ndërprerja e përkohshme e praktikës profesionale**

1. Praktika profesionale mund të ndërpritet përkohësisht në rastet kur kandidati, për shkaqe të arsyetuara, nuk është në gjendje të vazhdojë ndjekjen e rregullt të praktikës profesionale.
2. Shkaqe të arsyetuara për ndërprerjen e përkohshme të praktikës konsiderohen, por nuk kufizohen në:
  - 2.1. sëmundje e vërtetuar me dokumentacion mjekësor përkatës;

- 2.2. obligime familjare ose personale të pashmangshme;
- 2.3. rrethana të jashtëzakonshme që pamundësojnë pjesëmarrjen e rregullt në praktikë.
3. Ndërprerja e përkohshme e praktikës realizohet vetëm me kërkesë me shkrim të kandidatit, e cila i paraqitet institucionit pritës dhe i nënshtrohet aprovimit nga personi përgjegjës për mbikëqyrjen e praktikës, përkatësisht Kryeinfermieri / përgjegjësi i institucionit shëndetësor.
4. Mbikëqyrësi i praktikës obligohet të evidentojë ndërprerjen e përkohshme të praktikës në dokumentacionin përkatës dhe ta njoftojë institucionin pritës, si dhe Odën e Infermierëve të Kosovës, sipas nevojës.
5. Periudha e ndërprerjes së përkohshme nuk llogaritet në kohëzgjatjen e përgjithshme të praktikës profesionale.
6. Pas përfundimit të shkaqeve të ndërprerjes, kandidati është i obliguar të vazhdojë praktikën për pjesën e mbetur, në përputhje me orarin, kushtet dhe mbikëqyrjen e përcaktuar nga institucioni pritës.
7. Në rast të ndërprerjeve të shpeshta ose të zgjatura, institucioni pritës, në bashkëpunim me Odën e Infermierëve të Kosovës dhe mbikëqyrësin e praktikës profesionale, mund të vendosë për:
- 7.1. përsëritjen e pjeshme të praktikës profesionale; ose
- 7.2. përsëritjen e plotë të praktikës profesionale.

### **Neni 8**

#### **Kryerja e praktikës profesionale**

1. Praktika profesionale kryhet në institucionet shëndetësore të kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor, siç është përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
2. Kryerja e praktikës profesionale është e detyrueshme dhe duhet të realizohet në institucionet shëndetësore të akredituara në fushën e profilit përkatës.

### **Neni 9**

#### **Procedura e aplikimit**

1. Profesionisti shëndetësor dhe bashkëpunëtorët profesionalë nga neni 6, pas diplomimit, obligohen të aplikojnë në OIK për marrjen e librezës së praktikës profesionale dhe planprogramit për fushën përkatëse, përmes formularit sipas shtojcës 2.
2. Profesionistët shëndetësorë që kanë diplomuar jashtë vendit duhet të bashkëngjisin vendimin për nostrifikim të diplomës nga MASHTI.
3. Dokumentet për paraqitjen e praktikës profesionale:
  - o Formulari i aplikimit;
  - o Kopja e diplomës e noterizuar;
  - o Kopja e dokumentit identifikues.
4. Profesionistët shëndetësorë të regjistruar në regjistrin zyrtar, të cilët kanë diplomuar jashtë vendit, përveç dokumenteve të mësipërme, obligohen të kenë përfunduar nostrifikimin e diplomës së shkollës së mesme nga MASHTI.

### **Neni 10**

#### **Të drejtat dhe përgjegjësitë e praktikantit**

1. **Të drejtat e praktikantit:**
  - 1.1 Të zhvillojë praktikën profesionale në përputhje me programin e miratuar të praktikës dhe profesionin përkatës.
  - 1.2 Të trajtohet me dinjitet, pa diskriminim mbi bazë gjinie, moshe, përkatësie etnike, bindjeje politike apo fetare.

- 1.3 Të pajiset me dokumentacion përkatës (librezë praktike, vërtetim ose certifikatë) pas përfundimit të praktikës profesionale.
- 1.4 Të paraqesë ankesa për çdo veprim ose mosveprim që pengon zhvillimin efektiv të praktikës profesionale.

## **2. Përgjegjësitë e praktikantit:**

- 2.1 Respektimi i Kodit Etik dhe parimeve të deontologjisë profesionale, dhe raportimi i të gjitha abuzimeve.
- 2.2 Respektimi i rendit shtëpiak dhe rregullave të institucionit shëndetësor.
- 2.3 Ndjekja e praktikës profesionale në mënyrë të rregullt dhe evidentimi i pranisë.
- 2.4 Të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe dokumentacionit me të cilin njihet gjatë praktikës profesionale

### **Neni 11**

#### **Detyrimet e institucionit shëndetësor dhe mbikëqyrja e praktikës profesionale**

1. Institucionet shëndetësore obligohen që të plotësojnë standardet e domosdoshme për realizimin e kërkesave dhe përvetësimin e njohurive praktike, teknike dhe etike nga ana e praktikantit;
2. Të sigurojnë që praktika profesionale udhëhiqet dhe zhvillohet nën drejtimin e një profesionisti të kualifikuar, të licencuar dhe të pavarur, më së paku të ketë 3 vite përvojë pune.
3. Të bëjnë vlerësimin përfundimtar për praktikantin, lidhur me përvetësimin efektiv të njohurive praktike, teknike dhe etike, të cilat i garantojnë aftësitë e domosdoshme dhe përgjegjësinë publike;
4. Vlerësimin përfundimtar e kryen Kryeinfermieri /përgjegjësi i institucionit shëndetësor;
5. Të mbajnë evidencë të kandidatëve që kryejnë praktikën profesionale;
6. Të vendosin vulën e institucionit dhe nënshkrimin e personave përgjegjës në librezën e praktikës profesionale;
7. Të lëshojnë dëshmi që kandidati ka kryer praktikën profesionale.

### **Neni 12**

#### **Përsëritja e praktikës profesionale**

Nëse profesionisti shëndetësor nuk aplikon për licencim brenda pesë (5) vitesh pas përfundimit të praktikës profesionale, ai/ajo obligohet të përsërisë praktikën profesionale.

### **Neni 13**

#### **Praktika profesionale e kryer jashtë vendit**

Profesionistët shëndetësorë që kanë përfunduar praktikën jashtë Republikës së Kosovës mund të aplikojnë për licencim, duke bashkëngjitur dokumentin e lëshuar nga MSH për barazvlerësim të praktikës.

### **Neni 14**

#### **Mbizotërimi i dispozitave**

Dispozitat e akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë dhe janë në kundërshtim me këtë rregullore, nuk zbatohen.

## **Neni 15 Shtojcat**

1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë:
  - 1.1 Shtojca 1 – kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për profilet me përgatitje të mesme dhe të lartë shkollore (niveli IV dhe V) nga neni 6 i kësaj rregulloreje.
  - 1.2 Shtojca 2 - formulari i aplikimit.
2. Shtojcat mund të ndryshohen me propozim të komisioneve për licencim të fushave përkatëse nga neni 6 i kësaj rregulloreje.

## **Neni 16 Dispozitat kalimtare**

1. Profesionistët shëndetësorë që, në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, ndodhen në proces të praktikës profesionale, vazhdojnë praktikën sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në momentin e fillimit të praktikës.
2. Praktikant profesional të përfunduar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje njihen si të vlefshme.
3. Profesionistët shëndetësorë që kanë përfunduar shkollimin para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe nuk e kanë filluar praktikën profesionale, obligohen që praktikën ta realizojnë sipas kësaj rregulloreje.
4. Oda e Infermierëve të Kosovës siguron zbatimin e kësaj rregulloreje për praktikant profesional që fillojnë pas hyrjes së saj në fuqi.

## **Neni 17 Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore që janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

## **Neni 18 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 Korrik 2026.



Kryetare e OIK  
Nexhmije Gori

**SHTOJCA 1:**

**Tabela 1:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për teknikë të infermierisë dhe bashkëpunëtorë, mami dhe teknik të pediatriisë me arsim të mesëm (niveli IV dhe V)

<b>Teknikë të infermierisë dhe bashkëpunëtorë</b>		
<b>Institucioni</b>	<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përmbajtja</b>
QKMF, QMF, AMF dhe institucione private jo spitalore të fushës përkatëse.	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi i shtretërve,</li> <li>• Pjesëmarrje në vizita mjekësore,</li> <li>• Matja e shenjave vitale,</li> <li>• Mbledhja e mostrave,</li> <li>• Asistimi në dhënien e terapisë,</li> <li>• Përgatitja e pacientit për ekzaminime diagnostike;</li> </ul>
Institucione spitalore publike dhe private të licencuara në fushën përkatëse	3 Muaj	
<b>Mami</b>		
QKMF, QMF, AMF, dhe institucione private jo spitalore të fushës përkatëse	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kujdes prenatal,</li> <li>• Postnatal,</li> <li>• Asiston gjatë lindjes sipas nevojës,</li> <li>• Kujdes për nënën dhe të porsalindurin,</li> <li>• Zbaton masat e higjienës dhe parandalimin e infeksioneve,</li> <li>• Ndhmon në gjidhënie,</li> <li>• Edukon nënën për kujdesin bazë;</li> </ul>
Institucione Spitalore publike dhe private të licencuara gjinekologjike dhe obstetrike	3 Muaj	
<b>Teknik të pediatriisë</b>		
QKMF, QMF, AMF, dhe institucione private jo spitalore te fushes perkatese.	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shenjat vitale, rritje dhe zhvillimi (Ne rast te identifikimit te pengesave sipas moshës/peshës),</li> <li>• Evidencë pediatrike,</li> <li>• Kujdeset për higjienën dhe ushqyerjen,</li> <li>• Asiston në ekzaminime pediatrike,</li> <li>• Asiston në administrimin e terapisë sipas udhëzimeve,</li> <li>• Përgatit materiale mjekësore,</li> <li>• Asistimi gjatë vaksinimit dhe procedurave parandaluese,</li> <li>• Edukon prindërit për kujdesin bazë,</li> <li>• Respektimi i protokolleve të sigurisë dhe etikës profesionale;</li> </ul>
Klinikën e pediatriisë	1 Muaj	
Klinikën e neonatologjisë	1 Muaj	
Klinikën infektive – Reparti peadiatrik	2 Javë	
Klinikën e kirurgjisë pediatrike	2 Javë	

**Tabela 2:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për profilet teknike të stomatologjisë me përgatitje të mesme shkollë

<b>Asistentë të Stomatologjisë</b>		
<b>Institucioni</b>	<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përmbajtja</b>
Kujdesi Parësor Shëndetësor – Njësia e Stomatologjisë (QKMF)	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Roli dhe përgjegjësitë e asistentit stomatologjik</li> <li>• Rregullat e etikës profesionale dhe konfidencialitetit</li> </ul>
Klinika stomatologjike publike ne nivelin dytësor dhe tërësorë	1.5 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sterilizimi dhe dezinfektimi i instrumenteve/përdorimi I autoklaviv</li> <li>• Menaxhimi i mbetjeve mjekësore</li> </ul>
Ordinancë private të licencuar	1.5 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Plotësimi i kartelave stomatologjike</li> <li>• Menaxhimi i termineve</li> <li>• Komunikimi me pacientë</li> <li>• Edukimi shëndetësor</li> <li>• Asistimi në procedura të avancuara Endodonci (trajtime të kanalit të rrënjës)</li> <li>• Protetikë (kurora, ura, proteza) Kirurgji orale bazike</li> <li>• Stomatologji pediatrike</li> </ul>
<b>Teknik Dentar</b>		
Kujdesin Parësor Shëndetësor – Njësia e Stomatologjisë (QKMF)	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja me strukturën dhe funksionimin e laboratorit dentar</li> </ul>
Klinikë stomatologjike publike në nivelin dytësor dhe tërësor	1.5 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Proteza parciale dhe totale (baza)</li> <li>• Rregullimi dhe riparimi i protezave ekzistuese</li> <li>• Polirimi dhe përfundimi i punimeve</li> </ul>
Ordinancë private të licencuar	1.5 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja dhe përdorimi i materialeve dentare</li> <li>• Përpunimi i dyllit, metaleve dhe porcelanit bashkëpunimi me ekipin stomatologjik</li> </ul>
<b>Higjienist Dentar</b>		
Kujdesi Parësor Shëndetësor – Njësia e Stomatologjisë (QKMF)	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Etika profesionale dhe konfidencialiteti</li> <li>• Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale</li> <li>• Dezinfektimi dhe sterilizimi i instrumenteve</li> <li>• Parandalimi i infeksioneve ndërmjet pacientëve</li> </ul>
Klinika stomatologjike publike ne nivelin dytësor dhe tërësorë	1.5 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Asistim Pastrimi profesional i dhëmbëve (heqja e pllakës dhe gurëzave)</li> <li>• Këshillimi për higjienën orale ditore</li> </ul>
Ordinancë private të licencuar	1.5 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Edukimi i fëmijëve, të rriturve dhe grupeve të rrezikut</li> <li>• Instruksionet për larjen e dhëmbëve dhe përdorimin e fijos dentare</li> <li>• Parandalimi i kariesit dhe sëmundjeve parodentoze</li> <li>• Promovimi i shëndetit oral në komunitet</li> </ul>

**Tabela 3:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për teknik të fizioterapisë me përgatitje të mesme shkollë

Institucioni	Kohëzgjatja	Përmbajtja
QKUK/ Klinika Mjekësia Fizikale dhe Rehabilituese ose Spitali i Përgjithshëm, Qendra e Rehabilitimit: Bajë e Pejës, Bajë e Klllokotit apo baja tjera private të licencuara nga MSh	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbaton programin e fizioterapisë të përcaktuar nga fizioterapisti/mjeku.</li> <li>• Ndhmon pacientët gjatë ushtrimeve terapeutike dhe rehabilituese.</li> <li>• Aplikon procedura fizikale bazë (termoterapi, elektroterapi, ultrazë, masazh bazik etj.), sipas udhëzimit profesional.</li> </ul>
Klinika/Reparti i Ortopedisë me Traumatologji (gjatë kësaj kohe kandidati duhet të njoftohet edhe me problematikën fizioterapeutike në njësitë tjera kirurgjikale)	3 Javë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatit pacientin për trajtim dhe siguron pozicionimin e duhur gjatë procedurave.</li> <li>• Monitoron gjendjen e pacientit gjatë seancave dhe raporton çdo ndryshim apo reagim të padëshiruar.</li> <li>• Mban evidencë për seancat e kryera dhe raportimin ditor të punës.</li> <li>• Kujdeset për higjienën, dezinfektimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të fizioterapisë.</li> </ul>
Klinika/ Reparti i Neurologjisë	3 Javë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Respekton protokollet e sigurisë dhe rregullat e mbrojtjes në punë.</li> </ul>
Klinika/Reparti i Kardiologjisë	3 Javë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunon me ekipin multidisiplinar shëndetësor.</li> </ul>
Mjekësia Sportive (në Prishtinë)	3 Javë	

**Tabela 4:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për teknik të farmacisë me përgatitje të mesme shkollë

<b>Institucioni</b>	<b>Kohëzgjatja</b>	<b>Përmbajtja</b>
Barnatore private të licencuara	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pranim, ruajtje dhe shpërndarje e barnave, nën mbikëqyrje profesionale,</li> <li>• Përgatitje farmaceutike bazike sipas udhëzimeve,</li> <li>• Zbatim i rregullave të magazinimit dhe kontrolli i afateve të skadencës,</li> <li>• Këshillim bazik për përdorimin korrekt të barnave,</li> <li>• Zbatim i higjienës, sigurisë dhe etikës profesionale,</li> <li>• Evidentimi;</li> </ul>
QKMF në shërbimin farmaceutik	1.5 Muaj	
Institucione spitalore publike dhe private në shërbimin farmaceutik	1.5 Muaj	

**Tabela 5:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për teknik të radiologjisë me përgatitje të mesme shkollë

Institucioni	Kohëzgjatja	Përmbajtja
Niveli parësor ose dytësor publik	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e pacientit (Informon pacientin, ndihmon në pozicionim)</li> </ul>
Institucione publike të nivelit tretësor ose institucione private të licencuara në fushën e radiologjisë	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Asistimi-(Asiston teknikun/mjekun gjatë ekzaminimit)</li> <li>• Pajisjet-(Përgatit aparaturën bazë të rëntgenit)</li> <li>• Ekzaminimet-(Merr pjesë në radiografi bazë)</li> <li>• Dokumentimi-(Ndihmon në plotësimin e evidencës)</li> <li>• Imazhet-(Ndihmon në përpunim/arkivim)</li> <li>• Higjiena-(Zbaton rregullat e pastërtisë)</li> <li>• Siguria-(Përdor pajisje mbrojtëse nga rrezatimi)</li> <li>• Zbaton masat për mbrojtje nga rrezatimi jonizues, si për pacientin ashtu edhe për stafin.</li> <li>• Përgatit pacientin për ekzaminim, informon mbi procedurën, siguron pozicionimin korrekt dhe garanton privatësinë dhe dinjitetin e pacientit.</li> <li>• Kryen dokumentimin korrekt të ekzaminimeve radiologjike, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• regjistrimin e procedurave të kryera,</li> <li>• përdorimin e sistemeve informatike ,</li> <li>• ruajtjen e të dhënave sipas rregulloreve në fuqi.</li> </ul> </li> <li>• Bashkëpunon ngushtë me mjekun radiolog dhe stafin tjetër shëndetësor për realizimin optimal të shërbimit diagnostik.</li> <li>• Respekton rregulloren e brendshme të institucionit, kodin etik dhe standardet profesionale të shërbimit shëndetësor.</li> </ul>

**Tabela 6:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për teknik laborant me përgatitje të mesme shkollore

Institucioni	Kohëzgjatja	Përmbajtja
QKMF, QMF, AMF dhe institucione private jo-spitalore të fushës përkatëse	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistron të dhënat administrative të pacientit.</li> <li>• Përgatit ambientin e punës sipas protokollit (dezinfektim, materiale, pajisje).</li> <li>• Asistencë në marrjen, përpunimin dhe ruajtjen e mostrave biologjike, nën mbikëqyrje profesionale.</li> <li>• Kryerje e analizave laboratorike bazike sipas protokolleve dhe udhëzimeve standarde.</li> <li>• Përdorim dhe mirëmbajtje bazike e pajisjeve laboratorike dhe materialeve shpenzuese.</li> <li>• Zbatim i standardeve të biosigurisë, higjienës dhe etikës profesionale.</li> <li>• Evidentim dhe dokumentim i rezultateve laboratorike sipas procedurave institucionale.</li> </ul>
Institucione spitalore publike dhe private të licencuara në fushën përkatëse	3 Muaj	

**Tabela 7:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për teknik fitnes & nutricion me përgatitje të mesme shkollore

Institucioni	Kohëzgjatja	Përmbajtja
QKMF / Qendrat e Edukimit dhe Promovimit të Shëndetit	1.5 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatim i edukimit shëndetësor bazik në fushën e ushqyerjes, aktivitetit fizik dhe stilit të jetesës së shëndetshme.</li> <li>• Ofrim i këshillimit bazik nutricional dhe mbështetje në masat parandaluese për obezitetin, diabetin dhe sëmundjet kronike.</li> <li>• Monitorim dhe vlerësim bazik i peshës trupore, përbërjes trupore dhe statusit nutricional.</li> <li>• Zbatim i aktivitetit fizik të përshtatur dhe ushtrimeve parandaluese, në përputhje me udhëzimet profesionale.</li> <li>• Asistencë në hartimin e planeve ushqimore orientuese, rekomandimeve për hidratim dhe suplementim bazik.</li> <li>• Kryerje e vlerësimeve funksionale bazike (posturë, mobilitet, fleksibilitet, qëndrueshmëri).</li> <li>• Bashkëpunim ndërprofesional dhe pjesëmarrje në aktivitete të shëndetit publik.</li> </ul>
Klinika e Endokrinologjisë	3 Javë	
Klinika e Pediatriisë	3 Javë	
Mjekësia Sportive – institucione publike ose private të licencuara	1 Muaj	
IKSHPK – Divizioni për Ushqyeshmëri dhe Sigurinë e Ushqimit	2 Muaj	

**Tabela 8:** Kohëzgjatja dhe përmbajtja e praktikës profesionale për teknik të optikës me përgatitje të mesme shkollore

Institucioni	Kohëzgjatja	Përmbajtja
Institucione publike/private të licencuara për shërbime optike	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Asistencë në matjen bazike të mprehtësisë vizuale, nën mbikëqyrje profesionale.</li> </ul>
Institucione publike/private për shërbime oftalmologjike	3 Muaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitje, montim dhe rregullim i syzeve optike sipas recetës mjekësore.</li> <li>• Përpunim teknik i lenteve dhe kontroll bazik i cilësisë.</li> <li>• Këshillim teknik bazik për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve optike.</li> <li>• Zbatim i standardeve të higjienës, sigurisë dhe etikës profesionale.</li> <li>• Bashkëpunim me oftalmologë, optometristë dhe stafin shëndetësor.</li> <li>• Dokumentim bazik i punës teknike sipas procedurave institucionale.</li> </ul>

**SHTOJCA 2:**  
**FORMULAR APLIKIMI**  
**PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE**  
(Për profesionistë me shkollim të mesëm dhe të lartë)

Data e aplikimit: \_\_\_\_\_

**TË DHËNAT PERSONALE TË APLIKUESIT**

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

Numri Personal: \_\_\_\_\_

Data e lindjes: \_\_\_\_\_

Vendbanimi (adresa): \_\_\_\_\_

Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

**TË DHËNAT ARSIMORE DHE PROFESIONALE**

Institucioni i shkollimit të mesëm: \_\_\_\_\_

Drejtimi / Profili: \_\_\_\_\_

Data e diplomimit: \_\_\_\_\_

Institucioni ku është kryer praktika profesionale: \_\_\_\_\_

Kohëzgjatja e praktikës profesionale: \_\_\_\_\_

**DOKUMENTET PËR APLIKIM**

- Formulari i aplikimit;
- Kopja e diplomës e noterizuar;
- Kopja e dokumentit identifikues.

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të sakta dhe të plota.

Nënshkrimi i aplikuesit: \_\_\_\_\_